



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 958

Datë: 3 / 4 / 2020

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, lidhur me procesin e zgjedhjes dhe avancimeve akademike të rregulluara me nenin 173 pika 1 dhe nenit 177 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në bazë të veprimeve procedurale të rregulluara me nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/l-031 për Procedurën e përgjithshme administrative, në mbledhjen e mbajtur me datë 05. 03. 2020, mori këtë:

VENDIM

Dr. sc. Rina Hoxha zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët: Metodologji e punës shkencore MP (O), Metodatat kerkimore në fizioterapi FT (O), Hulumtimi dhe informatika në infermieri I (O), Projekti Shkencor, Shendet publik (viti VI-të) (O), në Fakultetin e Mjekësisë.

Zgjedhja është për periudhën 4 vjeçare.

Të lartpërmendurës i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me Ligjin e Punës dhe dispozitave tjera në fuqi.

Nëse e lartpërmendura ka një marrëdhënie të rregullt të punës në ndonjë institucion jashtë UP-së, duhet të dorëzojë një kopje me shkrim të dorëheqjes së saj.

Arsyetim

Universiteti i Prishtinës, me datën 22.10.2019 ka shpallur konkurs me nr. 2/872, për zgjedhjen e një mësimdhënësi, në Fakultetin e Mjekësisë, për lëndët: Metodologji e punës shkencore MP (O), Metodatat kerkimore në fizioterapi FT (O), Hulumtimi dhe informatika në infermieri I (O), Projekti Shkencor, Shendet publik (viti VI-të) (O).

Në bazë të Statutit të UP-së, kushteve të konkursit, udhëzimeve për procedurat që duhet të ndiqen nga njësitë akademike në lidhje me konkursin e sipërshtuar për zgjedhjen e personelit akademik, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, ka caktuar Komisionin recensues si dhe në afatin e paraparë ka shqyrtuar dhe ka aprovuar pozitivisht raportin e këtij Komisioni. Mbi këtë bazë, Këshilli i fakultetit i ka propozuar Senatit të Universitetit që Rina Hoxhën ta zgjedhë profesor asistent për lëndët e sipërshtuara.


Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 05. 03. 2020, duke vlerësuar edhe konstatimin e Komisionit Këshilldhënës, vendosi që Rina Hoxha të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët si në dispozitiv të këtij vendimi, **në Fakultetin e Mjekësisë.**

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur që ka qenë subjekt i këtij konkursi, kundër këtij vendimi ka të drejtë ankese tek Komisioni i Ankesave dhe të parashtresave të Senatit të Universitetit në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

Vendimi t'ju dorëzohet:

1. Të përmendurës;
2. Fakultetit;
3. Zyrtarit për paga;
4. Arkivit të Universitetit;
5. Zyrës për Çështje Akademike.



Prof. Dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së